

Shpend AVDIU
Instituti Albanologjik
Prishtinë

BANDAT SERBE NË VILAJETIN E KOSOVËS DHE NË VILAJETIN E MANASTIRIT GJATË VITEVE 1903-1908

Punim studimor

Përmbajtja e shkurtër: Në këtë punim studimor janë shqyrtuar organizimi, financimi dhe format e veprimeve të bandave serbe në Vilajetin e Kosovës dhe në Vilajetin e Manastirit në fillim të shekullit XX. Po ashtu, do të trajtohen krimet e shumta të çetnikëve ndaj popullsisë civile si dhe luftimet e tyre me bandat bullgare, trupat osmane dhe me shqiptarët. Kryesisht jemi bazuar në rezultate të historiografisë evropiane dhe ballkanike; posaçërisht jemi mbështetur në telegramet e agjencisë së lajmeve *Reuters*, të cilat janë transmetuar nga shtypi britanik dhe gjenden në *British Newspaper Archive*. Gjithashtu, kemi shfrytëzuar edhe dokumente britanike të kësaj periudhe, të cilat japin informacione të rëndësishme për financimin e bandave serbe.

Fjalët çelës: *Banda, çetnik, Vilajeti I Kosovës, Vilajeti i Manastirit, Perandoria Osmane, Serbia*

Në fillim të shekullit XX serbët synonin ta koordinonin dhe ta forconin banditizmin me karakter kombëtar. Në Beograd ishte organizuar “komiteti ekzekutiv” çetnik, me degët e tij në zona të ndryshme të Serbisë. Ndërkaq dega më madhe e tij e kishte vendndodhjen në Vranjë, e drejtuar nga Živojin Rafajlović, ku rekrutoheshin anëtarët e rinj në çetat komite serbe dhe nga aty organizohej edhe aktiviteti i tyre. Më pas, qeveria serbe e mbështeti

materialisht dhe financiarisht të gjithë veprimtarinë e saj.¹ Nga ana tjetër, duhet theksuar faktin se çetnikët nuk ishin një lëvizje e krijuar zyrtarisht nga institucionet shtetërore, si parlamenti ose qeveria. Megjithatë, ata kishin pëlqimin e shtetit serb dhe mbështeteshin me financa, armë e municione nga zyrtarët shtetërorë, qofshin ata ushtarakë apo zyrtarë qeveritarë. Çetnikët kishin ngjashmëri në veprimtarinë e tyre me komitët bullgarë dhe andartët grekë, pra me bandat që vepronin në Maqedoni, dhe përdorën të njëjtat taktika për t'u kundërvunë komitëve bullgarë. Këto banda, më vonë, ishin lidhur me organizatën “Mbrojtja Kombëtare”, që ishte një organizatë nacionaliste dhe terroriste. Ndërkaq, nga viti 1911, komanda e tyre i kishte kaluar organizatës “Bashkim ose vdekje”. Pavarësisht nga kjo, çetnikët kishin afërsi më të madhe me qeveritë civile në Beograd, sesa këto dy organizata terroriste.² Por është e vështirë të thuhet se në

¹ John Paul Newman, “Civil and military relations in Serbia during 1903–1914”, in: Ed. Dominik Geppert, William Mulligan, Andreas Rose, *The Wars before the Great War Conflict and International Politics before the Outbreak of the First World War*, (United Kingdom: Cambridge University Press, 2015), 122–123.; John Paul Newman, *Yugoslavia in the Shadow of War Veterans and the Limits of State Building, 1903–1945*, (United Kingdom: Cambridge University Press, 2015), 30; Tetsuya Sahara, “The Macedonian Origin of “Black Hand”, in: Ed. Srdjan Rudić & Miljan Milkić, *ПРВИ СВЕТСКИ РАТ, СРБИЈА, БАЛКАН И ВЕЛИКЕ СИЛЕ - First World War, Serbia, the Balkans and Great Powers*, (Belgrade. Институт за стратегијска истраживања & Историјски институт- Institute of History, 2015), 414–415; Zekeria Cana, *Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare 1903–1913*, (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2006), 18–20; Thoma Murzaku, *Politika e Serbisë kundrejt Shqipërisë gjatë Luftës Ballkanike 1912–1913*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë - Instituti i Historisë, 1987), 46–48; Skënder Latifi, *Çetnikët futeshin në Vilajetin e Kosovës me veshje kombëtare shqiptare*, në: <https://www.koha.net/kulture/397249/cetniket-futeshin-ne-vilajetin-e-kosoves-me-veshje-kombetare-shqip-shy-tare/>, 30 tetor 2023, qasur së fundmi më 11. 15. 2023.

² Alexey Timofeev, “Serbian Chetniks- Traditions of Irregular Warfare”, Ed. Katrin Boeckh and Sabine Rutar, in: *The Wars of Yesterday- The Balkan Wars and the Emergence of Modern Military Conflict, 1912–13*, (New York-Oxford: berghahn, 2020), 262–264; Newman, “Civil and military relations in Serbia during 1903–1914”, in: Ed. Geppert, Mulligan, Rose, *The Wars before the Great War*, 122–124; Newman, *Yugoslavia in the Shadow of War*, 30; Sahara, “The Macedonian Origin of “Black Hand”, in: Ed. Srdjan Rudić & Miljan Milkić, *ПРВИ СВЕТСКИ РАТ, СРБИЈА, БАЛКАН И ВЕЛИКЕ СИЛЕ - First World War*, 418–422; Cana, *Politika e Serbisë*

çfarë mase bandat serbe financoheshin në Vilajetin e Kosovës nga shteti serb. Sipas dokumenteve britanike, shuma që kishin në dispozicion komitetet për veprimtarinë e tyre në Maqedoni gjatë vitit 1906 ishte 300.000 franga, fonde këto të miratuara nga Kuvendi, që jepeshin në emër të ndihmës për personat e varfër në Kosovë dhe në Maqedoni. Po ashtu, 300.000 franga përdoreshin nga Fondi i Shërbimit Sekret. Megjithatë, duhet të theksohet se sasia më e madhe e parave ishte e mbledhur nga serbët e pasur, rreth 800.000 franga, dhe nga maqedonasit e vendosur në Beograd, të cilët merreshin kryesisht me tregti dhe aktivitete të tjera, me rreth 40.000 franga. Gjithashtu, duhet të thuhet se një pjesë e këtyre fondeve ishin keqpërdorur.³ Gjatë një bisede që kishte pasur J. B. Whitehead me Nikola Pašićin, për veprimtarinë e bandave serbe në Maqedoni, ndër të tjera, Pašić deklaronte se sfera që pretendonte gjithmonë Serbia ishte Vilajeti i Kosovës, veçanërisht tri qendrat e saj kryesore: Shkupi, Prishtina dhe Prizreni. Pašić-i theksonte se në dy dekadat e fundit vazhdimisht ishte diskutuar për ndarjen e sferave të ndikimit në Maqedoni nga qeveria serbe edhe ajo bullgare. Këto të dhëna tregojnë qartë se bandat serbe, që bënë dhunë, subvencionoheshin nga Serbia dhe pjesërisht drejtoheshin nga oficerë serbë.⁴ Në këtë kuadër, Serbia, në emër të ruajtjes së status-quo, që mbështetej edhe nga diplomacia

kundrejt çështjes shqiptare, 19-20, 94; Thoma Murzaku, Politika e Serbisë kundrejt Shqipërisë, 46-50.

³ G. P. Gooch & Harold Temperley and Lillian M. Penson, Ph.D. (Ed), *British Documents on the Origins of the War 1898-1914, Vol. V, The Near East -The Macedonian Problem and the Annexation of Bosnia 1903-9*, (London : Printed and published by His Majesty's Stationery Office - To be purchased directly from H.M. STATIONERY OFFICE at the following addresses : Ad astral House, Kingsway, London, W.C.2 ; 120, George Street, Edinburgh; York Street, Manchester; 1, St. Andrew's Crescent, Cardiff; 15, Donegall Square West, Belfast; or through any Bookseller, 1928), (A.) — Extract from Annual Report for Servia for the Year 1906. (Enclosure in Despatch from Mr. J. B. Whitehead, No. 26 of April 11, 1907.), 116-117; Douglas Dakin, *The Greek struggle in Macedonia 1897-1913*, (ΘΕΣΣΑΛΟΝΙΚΗ : Institute for Balkan Studies, 1966), 253.

⁴ G. P. Gooch & Temperley and M. Penson, Ph.D. (Ed), *British Documents on the Origins of the War 1898-1914, Vol. V, The Near East- The Macedonian Problem and the Annexation of Bosnia 1903-9*, ** [[Mr. Whitehead to Sir Edward Grey., Belgrade, D. February 15, 1907. R. February 22, 1907., 117; Dakin, *The Greek struggle in Macedonia*, 331-332.

ruse, kërkonte shtrirjen e reformave në Vilajetin e Kosovës e në anën tjetër synonte që kësaj zone t'i njihej karakteri sllav. Në lidhje me këtë si arsytim kishte ruajtjen e qetësisë dhe ndalimin e “zullumeve shqiptare”, që ishin zmadhuar. Madje, për këtë, qeverisë serbe i shkruanin dhe diplomatët si M. Rakić, në vitin 1905, se lista e akteve të dhunës ishte zmadhuar. Këto zmadhime bëheshin nga serbët e Kosovës, me qëllim të përfitimeve personale që të merrnin para dhe armë sa më shumë nga Serbia.⁵ Beogradi, sërish zyrtarisht, më 1902 e ngriti çështjen e mbrojtjes së serbëve. Disa nga kërkesat e serbëve ndaj Perandorisë Osmane ishin: ndalimi i politikës së inkurajimit të shqiptarëve, çarmatosja e shqiptarëve dhe zëvendësimi i nëpunësve të korruptuar osmanë si dhe, të lejoheshin serbët të bartnin armë, pastaj përforcimi i garnizoneve osmane në zonat e përziera shqiptaro-serbe etj., kërkesa këto që përkraheshin edhe nga Rusia.⁶ Kështu, këmbëngulja e Serbisë për çarmatosjen e shqiptarëve dhe asgjësimin e çetave shqiptare bëhej në vazhdimësi, me synimin që të hapej rruga për organizimin e bandave serbe në Kosovë. Serbia u angazhua, gjithashtu, që të armatoste popullsinë serbe me pretekstin që ajo të mbrohej nga shqiptarët, kurse furnizimin më armë e morën si detyrë personeli i konsullatës serbe në Prishtinë dhe në Shkup.⁷

Qysh në fund të shekullit XIX, por edhe më vonë, Serbia ushtronte presion në Stamboll që të merrte masa për parandalimin, siç thuhej të “zullumeve” nga ana e shqiptarëve ndaj elementit serb. Perandoria Osmane në vitin 1897 kishte dërguar në Vilajetin e Kosovës një komision (*komitet*) hetimor të udhëhequr nga gjenerali, Sadedin Pasha, i cili kishte vizituar rrethinën e Pejës, ndërsa pas hetimeve të zhvilluara, komisioni nuk kishte gjetur asgjë serioze dhe kishte ardhur në përfundim se të gjitha “provat” e qeverisë serbe ishin

⁵ Zekeria Cana, *Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare*, 11-18; Gábor Demeter & Krisztián Csaplár-Degovics, *A Study in the Theory and Practice of Destabilization: Violence and Strategies of Survival in Ottoman Macedonia (1903-1913)*, (Istanbul: The Isis Press, 2018), 118; Murzaku, *Politika e Serbisë kundrejt Shqipërisë*, 51.

⁶ Demeter & Csaplár-Degovics, *A Study in the Theory and Practice of Destabilization*, 116; Skënder Latifi, *Çetnikët futeshin në Vilajetin e Kosovës me veshje kombëtare shqiptare*, në: <https://www.koha.net/kulture/397249/cetniket-futeshin-ne-vilajetin-e-kosoves-me-veshje-kombetare-shqip-shy-tare/>, 30 tetor 2023, qasur së fundmi më 11. 15. 2023.

⁷ Cana, *Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare*, 19.

të fryra dhe të trilluara⁸. Parë nga ky rrafsh, duhet pohuar se kjo retorikë zhvillohej edhe më herët, dhe një rast i tillë ishte edhe ai vitit 1887, kur autoritetet civile dhe ushtarake osmane kishin filluar hetimet në kufirin osmano-serb, nën pretekstin e kalimit të bandave shqiptare në territorin serb. Ndërsa, në qershor të këtij viti, autoritetet osmane i telegrafonin Portës se një grup serbësh prej rreth 30 vetash kishin kaluar kufirin afër Velekincës, territor i banuar me shqiptarë, ku kishin plaçkitur dy dema dhe kishin plagosur një fëmijë. Megjithatë, shqiptarët kishin arritur t'i dëbonin grabitësit, por ky rast nuk ka të bëjë me bandat çetnike, por, mesa shihet, ka të bëjë me banda grabitësisht ordinerë.⁹

Përgjithësisht, banda nga shtetet fqinje që hynin në Perandorinë Osmane sollën dhunë e terror, duke prekur pa dyshim edhe hapësirat shqiptare. Këtë e dëshmon edhe depërtimi i bandave serbe në Kosovë, të cilat kishin në mesin e tyre edhe oficerë serbë, duke mos përjashtuar as Vilajetin e Manastirit, ku vepronin edhe guerilje bullgare, greke e shqiptare.¹⁰ Por, duhet të ceket edhe një e dhënë e diplomatit austro-hungarez, Alfred Rappaport, ku theksohet se Valiu i Kosovës, Hafëz Mehmed Pasha, e ndoshta edhe me urdhër të Pallatit, kishte miratuar një taktikë jo të mençur, që i ushqente apetitet serbe me synimin e qartë që të kundërshtonin bullgarët. Për t'i arsyetuar vlerësimet e tij, ai konstatonte: *Nëse ai do ta dinte paraprakisht se të njëjtit serb do ta shkëpusin provincën e tyre nga Turqia, duke u mbështetur në miratimin e këtij pashai, vështir se do të kishte vepruar ashtu.*¹¹ Nga ky përfundim, ai, në një farë mënyre, shfaq

⁸ Cana, *Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare*, 16- 17; Demeter & Csaplár-Degovics, *A Study in the Theory and Practice of Destabilization*, 114-115, Murzaku, *Politika e Serbisë kundrejt Shqipërisë*, 50-51.

⁹ The British Newspaper Archive - <https://www.britishnewspaperarchive.co.uk>, (më tej BNA), *THE SERVO-ALBANIAN FEUD*, "The Warwickshire Herald", Warwickshire, England, Thursday 30 June 1887,7; BNA, *THE RUMOURED ALBANIAN RAID*, "The Nottingham Evening Post", Nottinghamshire, England, Wednesday 29 June 1887, 2; BNA, *TURKEY AND SERVIA*, "The Devon and Exeter Daily Gazette", Devon, England, Thursday 30 June 1887, 4.

¹⁰ Gorge Gawrych, *Gjysmëhëna dhe Shqiptarët- Sundimi Otoman, Islamizimi dhe Shqiptarët*, 1874-1913, (Tiranë: Bota shqiptare, 2007), 206.

¹¹ Alfred Rappaport, "Shkupi i heroizmave, tmerreve dhe lotëve të derdhur", në: *Shkupi në kohë të paqes dhe tmerreve 1858-1944*, Ed. Skënder Latifi. (SHKUP,

politikën e gabuar osmane të ndjekur ndaj Serbisë. Pra, kjo ndodhte pikërisht në kohën e shfaqjes së aktiviteteve të Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase, veçanërisht kur për herë të parë autoritetet osmane kishin zbuluar aktivitetin e saj, në Vinicë të Koçanit në vitin 1897, dhe pas atentateve me bomba në Kumanovë.¹²

Shteti serb dhe komiteti i Beogradit kishin interesa të përbashkëta, që aktet e banditizmit, së bashku me veprimtarinë guerile, t'i shërbenin shtetit serb të nacionalizonte (serbizonte) hapësirat osmane në Ballkan. Pa dyshim, qëllimi i çetnikëve ishte të serbizoheshin zonat ku ata vepronin, dhe t'ia nguliste identitetin kombëtar serb popullsisë së krishterë ortodokse. Pra, shoqëritë kulturore, kisha dhe shkollat së bashku me bandat vepronin në këtë drejtim. Por, duhet cekur se formacionet çetnike nuk e kishin plaçkën në plan të parë, por terrorizimin dhe frikësimin e popullsisë që nuk ishte serbe, me synim t'i serbizonin territoret ku vepronin, për të cilat kishte pretendime Serbia dhe që synonte t'i pushtonte.¹³ Madje, një pjesë e çetnikëve të njohur ishin, ish-murgj, mësues etj., të cilët, më pastaj u bënë gazetarë e deputetë. Në mesin e tyre ishte mësues Jovan Stojković, ndërsa gazetarë Steven Simić dhe Stanislav Krakov, si dhe deputetë Vasilije Trbić dhe Puniša Račić.¹⁴ Megjithatë, një pjesë udhëheqësve të çetnikëve ishin dhe kriminelë, midis të cilëve ishte edhe Vasilije Trbić, i cili më herët kishte qenë murg në Malin Athos dhe ishte larguar prej aty në vitin 1902. Ky i fundit ishte i akuzuar për vrasjen e disa murgjve grekë, por në vitin 1924 u zgjodh deputet.¹⁵

Ndërsa zhvillimet e mëvonshme, sidomos ato pas grushtit të shtetit të vitit 1903 në Beograd, dhe ndryshimit të qeverisë dhe

PRISHTINË, TIRANË: LOGOS ·A, 2022), 96; Gjithashtu shih dhe shënimet e përgatitësit të këtij materiali, Skënder Latifi.

¹² Rappaport, "Shkupi i heroizmave, tmerreve dhe lotëve të derdhur", në: *Shkupi në kohë të paqes*", Ed. Skënder Latifi., 96; Gjithashtu shih dhe shënimet e përgatitësit të këtij materiali, Skënder Latifi.

¹³ Newman, "Civil and military relations in Serbia during 1903–1914", in: Ed. Geppert, Mulligan, Rose, *The Wars before the Great War*, 123; Newman, *Yugoslavia in the Shadow of War*, 30–31.; Murzaku, *Politika e Serbisë kundrejt Shqipërisë*, 12–13, 46–47

¹⁴ Newman, "Civil and military relations in Serbia during 1903–1914", in: Ed. Geppert, Mulligan, Rose, *The Wars before the Great War*, 123; Newman, *Yugoslavia in the Shadow of War*, 30–31; Ivo Banac, *The National Question in Yugoslavia: Origins, History, Politics*, (Ithaca and London: Cornell University Press, 1984), 316.

¹⁵ Banac, *The National Question in Yugoslavia*, 316.

dinastisë, si dhe Kryengritjes së Ilindenit dhe veçmas pas kërkesës për reforma Mürzsteg-ut, detyruan elitat politike në Beograd që t'i mbështesnin çetat serbe në këto territore. Po ashtu u mbajtën takime publike ku kërkohej njohja e pretendimeve serbe në Vilajetin e Kosovës. Në këtë kuadër, edhe studiuesit serbë përpunuan të dhëna që të bënin lidhjen historike dhe etnike me sllavët e kësaj pjese. Aksionet serbe gjatë viteve 1904 -1905 filluan pas krijimit të këshillit ekzekutiv në Vranjë, i cili merrej me veprimtarinë e çetave. Në këshillin e saj bënin pjesë gjenerali Jovan Atanasković, një ndër figurat kryesore të grushtshtetit të vitit 1903, si dhe kapiteni Dragutin Dimitrijević, i cili, po ashtu, ishte pjesëmarrës, e më vonë, në vitin 1913 ishte edhe shef i inteligjencës së ushtrisë. Gjithashtu, ato stërviteshin nga ushtria dhe pastaj hidheshin përtej kufijve, kurse veprimet e tyre shpeshherë ishin terroriste.¹⁶

Qysh në vitin 1903 kishin filluar përgatitjet e çetnikëve nga oficeri Živojin Rafajlović, i cili kishte themeluar Komitetin e Vrajnës, i cili më pas ishte bashkuar me atë të Beogradit dhe ishte bërë degë ekzekutive e tij. Veprimtaritë e para të armatosura nga lëvizja çetnike, të dërguara nga Rafajlović-i, kishin ndodhur në Luginën e Preshevës.¹⁷ Pikërisht në këtë kohë shtypi britanik njoftonte se për shkak të

¹⁶ Murzaku, *Politika e Serbisë kundrejt Shqipërisë*, 46-48; Sahara, "The Macedonian Origin of "Black Hand", in: Ed. Srdjan Rudić & Miljan Milkić, *ПРВИ СВЕТСКИ РАТ, СРБИЈА, БАЛКАН И ВЕЛИКЕ СИЛЕ - First World War*, 404- 415; Cana, *Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare, 19-21*; Dejan Djokić, *A Concise History of Serbia*, (Cambridge, United Kingdom; New York: Cambridge University Press, 2023), 336.; Steven W. Sowards, *Austria's policy of Macedonian reform*, (Boulder & New York: East European Monographs by Columbia University Press, 1989), 44, 76; Newman, "Civil and military relations in Serbia during 1903-1914", in: Ed. Geppert, Mulligan, Rose, *The Wars before the Great War*, 122-124; Timofeev, "Serbian Chetniks-Traditions of Irregular Warfare", Ed. Katrin Boeckh and Sabine Rutar, in: *The Wars of Yesterday*, 260-265.

¹⁷ Sahara, "The Macedonian Origin of "Black Hand", in: Ed. Srdjan Rudić & Miljan Milkić, *ПРВИ СВЕТСКИ РАТ, СРБИЈА, БАЛКАН И ВЕЛИКЕ СИЛЕ - First World War*, 415-416; "Më 29 gusht 1903 rreth orës 01:00 pas mesnate në ndërtesën e shkollës fillore në Vranjë u betuam mbi Ungjillin, thikën dhe revolen. Betimin tonë e bekoj prifti i moshuar i Vranjës, Dimitrije Protiq", do të kujtojë më vonë Rafajloviq dhe kjo dëshmohet edhe me anë të një dokumenti të arkivuar." Për më shumë shih: Latifi, Çetnikët futshin në Vilajetin e Kosovës më veshje kombëtare shqiptare, në: <https://www.koha.net/kulture/397249/cetniket-futeshin-ne-vilajetin-e-kosoves-me-veshje-kombetare-shqip-shy-tare/>, 30 tetor 2023, parë më 11. 15. 2023.

sulmeve të bandave nga territori serb në Kosovë, rreth 10 mijë shqiptarë kërcënonin se do ta kalonin kufirin e Serbisë. Në këtë situatë, Porta ishte detyruar ta angazhonte Shemsi Pashën për ta parandaluar këtë kalim të shqiptarëve me çdo mjet të mundshëm.¹⁸ Po ashtu, në vitin 1904 kishte lëvizje të mëdha të bandave, sidomos në rrethin e Xhumaibalës (Djumaibala), ku detashmentet osmane, përveç se duhej të përballeshin me sulmet e bandave bullgare, të cilat shkaktonin humbje të konsiderueshme, ushtria osmane njëkohësisht duhej të përballej edhe me depërtimin e bandave të ndryshme serbe, që ishin të gatshme të futeshin në territorin osman.¹⁹ Në këtë vijimësi, në qershor të vitit 1904, Nikola Pašić u kërkonte konsullatave serbe në Perandorinë Osmane që t'i kundërshtonin ashpër komitetët bullgarë e, po ashtu, qeveria ndau një shumë të madhe parash e sasi të madhe të armatimit. Bazuar në të dhënat që i ofron studiuesi Sahara, konsullatat serbe në Prishtinë, Shkup dhe Manastir u bënë shtabe të operacioneve guerile. Për organizimin e bandave nga Serbia në këtë kohë, një ndër oficerët më të rëndësishëm ishte edhe Ilija Jovanović-Pčinski, ndërkaq si shef i shtabit malor gjatë vitit 1905 më sukses i kishte organizuar çetat serbe në Kosovë dhe rrjedhën e epërme të Vardarit.²⁰ Përveç kësaj, bandat serbe gjatë vitit 1904 kryenin krime të shumta, e një nga këto ishte vrasja e një drejtuesi të një shkolle (kryemësuesi) dhe disa personave të tjerë afër Kumanovës.²¹ Për vrasjet e civilëve bullgarë shkruante dhe konsulli austriak, Alfred Rappaport, i cili merrte si shembull vrasjen e dy fshatarëve bullgarë në vitin 1906, afër fshatit Vodno e Epërme. Nga hetimet që ishin kryer, vrasësit e këtyre fshatrave bartnin plisa të bardhë, porse në realitet

¹⁸ BNA, BALKAN WARFARE -Border Demonstrations. ALBANIANS THREATENING SERVIA, "The Echo", London, England, Friday 09 October 1903, 3.

¹⁹ BNA, BALKANREFORM SCHEME. THE PORTE'S REPLY. TURKISH GARRISON REVOLT. BULGARIAN ACTIVITY. "The Devon and Exeter Daily Gazette", Devon, England, Thursday 14 January 1904, 6.

²⁰ Sahara, "The Macedonian Origin of "Black Hand", in: Ed. Srdjan Rudić & Miljan Milkić, ПРВИ СВЕТСКИ РАТ, СРБИЈА, БАЛКАН И ВЕЛИКЕ СИЛЕ - First World War, 416-417.

²¹ "Yesterday a large Servian band attacked Bulgarian village near Kumanovo, and killed a schoolmaster and several others." BNA, GENERAL FOREIGN TELEGRAMS, "The Londonderry Sentinel", Londonderry, Northern Ireland, Thursday 10 November 1904, 8.

asnjëherë nuk ishte vërtetuar se ata ishin shqiptarë, apo pjesëtarë të një bande të maskuar si shqiptarë.²² Gjithashtu, A. Rappaport shkruan për situatën e pafavorshme politike që sundonte në Shkup si rezultat i rivalitetit serbo-bullgar dhe luftës guerile të vazhdueshme ndërmjet tyre, ku të dy palët ushtronin mizori mbi popullsinë dhe të dy popujt sllavë, theksonte, se vrisnin njëri-tjetrin.²³ Për këtë mënyrë veprimi të serbëve, të cilët maskoheshin si shqiptarë, raportonte edhe gazeta britanike *The Manchester Courier*. Ajo shkruante, ndër të tjera: *Dje një bandë serbe prej njëzet burrash të maskuar si shqiptarë u ndeshën me trupat turke,... në rrethin e Kumanovës, duke humbur dy të vranë.*²⁴ Një shembull i ngjashëm kishte ndodhur edhe më herët, kur pjesëtarët e një bande serbe të maskuar me veshje shqiptare kishin kaluar në Kosovë, në fshatrat e Bujanofcit. Një pjesë e çetnikëve ishin edhe pjesëtarë të komunitetit serb, që më parë kishin jetuar në zonat ku flitej shqip dhe, pos që futeshin në Vilajetin e Kosovës me veshje shqiptare, ata flisnin mirë dhe gjuhën shqipe. Përveç këtij fenomeni, ka raste edhe më paradoksale, në dukje të parë, e një nga këto ishte falja e namazit nga Vojvoda Spasa Tanović në xhami të ndryshme të Anamoravës dhe të Preshevës.²⁵ Po në këtë mënyrë vepronin edhe bandat bullgare. Sipas studiueses Mucize Ünlü, komitët bullgarë për qëllime të tyre vepronin me veshje greke ose shqiptare, duke rrëmbyer dhe vranë konsuj e personalitete fetare, me synim që të portretizonin shtetin osman se nuk mund ta siguronte paqen në Maqedoni.²⁶

²² Rappaport, Shkupi i heroizmave, tmerreve dhe lotëve të derdhur, në: Shkupi në kohë të paqes dhe tmerreve 1858-1944, Ed. Skënder Latifi., 102.

²³ Rappaport, Shkupi i heroizmave, tmerreve dhe lotëve të derdhur, në: *Shkupi në kohë të paqes dhe tmerreve 1858-1944*, Ed. Skënder Latifi., 99- 100.

²⁴ "Yesterday a Servian band of twenty men disguised as Albanians had an encounter with Turkish troops Startcha, in the Cumanovo district, losing two killed". BNA, HUMAN EAR BY POST. GRUESOME REMINDER CAPTIVE ENGLISHMAN MUTILATED. [Retjter's Telegrams.]- *Internecine Warfare. Salonika, October 14.*, "The Manchester Courier", Manchester, Lancashire, England, Tuesday 10 October 1905, 7.

²⁵ Latifi, Çetnikët futeshin në Vilajetin e Kosovës me veshje kombëtare shqiptare, në: <https://www.koha.net/kulture/397249/cetniket-futeshin-ne-vilajetin-e-kosoves-me-veshje-kombetare-shqip-shy-tare/>, 30 tetor 2023, qasur së fundmi më 11. 15. 2023.

²⁶ Mucize Ünlü, *Vilajeti i Kosovës (1877-1912)*, (Tiranë: Dituria, 2023), 269.

Për dallim nga Maqedonia, çetat serbe në Kosovë ishin më të vogla, megjithatë bënin luftë guerile dhe kryenin akte terroriste. Ajo që bënte punë në Maqedoni nuk funksiononte në brendi të Vilajetit të Kosovës. Pra, çetat serbe, që lejoheshin nga osmanët të luftonin kundër bullgarëve në Maqedoni, në brendësi të Kosovës, një rrethanë tillë me shumë akterë mungonte dhe në anën tjetër, osmanët nuk i lejonin sulmet kundër myslimanëve. Shembull tipik i kësaj që u tha është edhe rasti i Hoqës së Madhe, në vitin 1905, ku një bandë serbe pësoi humbje të madhe në njerëz. Po ashtu, edhe një bandë tjetër, e cila ishte futur në rrethin e Gjilanit, u shkatërrua plotësisht afër fshatit Pasjanë, në vitin 1907. Lidhur më këtë, Rakić i shkruante ministrit të Jashtëm, se dërgimi i çetave në brendësi të Kosovës, pra përtej Kaçanikut, ku popullsia shqiptare ishte dërrmuese, jo vetëm që do të ishte dështim, por shkonte dhe në dëm të popullatës serbe. Madje, edhe ambasadori rus në Stamboll, kundërshtonte që të dërgoheshin çeta në Kosovë, sepse mund të provokonte një goditje mbi popullatën serbe. Gjithashtu, edhe Saplajković, konsulli serb në Prishtinë, paralajmëroi Beogradin se kalimi i bandave serbe përmes Kosovës në Maqedoni mund të shkaktonte pasoja të mëdha. Për asgjësimin e bandës serbe në rrethin e Gjilanit raportonte edhe agjencia *Reuters*, në korrik të vitit 1907, e cila theksonte se fshatarët shqiptarë, të ndihmuar nga trupat osmane, kishin shfarosur një bandë serbe prej 65 burrave.²⁷ Po ashtu, në prill të vitit 1905, shqiptarët dhe trupat osmane kishin shkatërruar një bande serbe pranë Kumanovës në Tabanoc, me rreth pesëmbëdhjetë- gjashtëmbëdhjetë burra nën drejtimin e Vladimir Kovatchevitch-it, synimi i së cilës ishte mbrojtja e interesave serbe nga propaganda bullgare.²⁸ Pra, ky grup ishte i

²⁷ Cana, *Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare*, 21-22; Demeter & Csaplár-Degovics, *A Study in the Theory and Practice of Destabilization*, 120; BNA, *SERVIAN BAND EXTERMINATED*, "Birmingham Gazette & Express", Warwickshire, England, Wednesday 24 July 1907, 5; BNA, *FIGHT BETWEEN ALBANIANS AND SERVIANS. Band of 65 Men Exterminated. SALONIKA, July 22.*, "The Evening Chronicle", Northumberland, England, Wednesday 24 July 1907, 5; Dakin, *The greek struggle in Macedonia*, 306.

²⁸ Megjithatë, në artikullin, "[The Londonderry Sentinel](#)" përdorej një gjuhë tejet propaganduese dhe tendencioze ndaj shqiptarëve. Ajo propagandonte se ishin përhapur thashetheme se 1000 shqiptarë ishin mbledhur për të plaçkitur qytetin e Kumanovës dhe po masakronin të krishterët. Po ashtu, në këtë artikull akuzoheshin

organizuar nga Komiteti Maqedonas i Beogradit me qëllim që t'i kundërshtonte bandat bullgare. Në të njëjtën kohë, qëllimi i bandave bullgare ishte pa dyshim parandalimi i propagandës serbe në Maqedoni.²⁹ Ndërsa, në fillim të majit të vitit 1905 raportohej për qindra ushtarë osmanë të vrarë dhe të plagosur nga një bandë serbe afër Kumanovës. Megjithatë osmanët kishin arritur ta shpërndanin këtë bandë dhe një pjesë e tyre u detyrua të largohej përtej kufirit serb.³⁰ Pavarësisht nga kjo, pak javë më vonë, në rrethin e Kumanovës, trupat osmane sërish ishin detyruar të zhvillonin luftime dhe ta shpartallonin një bandë serbe, duke vrarë 20 pjesëtarë të saj, kurse ushtria osmane kishte pasur një të vrarë dhe trembëdhjetë të plagosur.³¹ Situata nuk kishte ndryshuar edhe në fillim të vitit 1906,

ushtria osmane dhe turqit e Kumanovës për masakrimin dhe hedhjen e trupave të shtatë anëtarëve të bandës në oborrin e një kishe serbe në Kumanovë, të cilën e pohon dhe Reuters. BNA, *SERVIAN BAND MASSACRED. BRUTAL ACTION OF ALBANIANS*, "*The Londonderry Sentinel*", Londonderry", Northern Ireland, Saturday 15 April 1905, 6; "*The band, numbering some 15 or 16 men, under Vladimir Kovatchevitch, was one of several bands lately formed the Servian inhabitants of the Kosovo Vilayet in order to defend Servian interests against the encroachments of the Bulgarian Propaganda.*" Megjithëkëtë, kjo bandë nuk ishte formuar nga banorët serbë të Vilajetit të Kosovës, por ishte organizuar nga Komiteti Maqedonas i Beogradit. BNA, *RIVAL BANDS IN MACEDONIA. GREEKS KILL 30 VILLAGERS*, "*The Daily News*", London, England, Wednesday 12 April 1905,7; "*The band was organised by the Belgrade Macedonian Committee with the view of opposing Bulgarian bands whose object was the prevention of the Servian propaganda in Macedonia.*" BNA, *SERVIAN BAND DESTROYED.*, (FROM OUR CORRESPONDENT.) VIENNA, April 6. "*The Standard*," London, England, Thursday 06 April 1905, 5; BNA, *SERVIAN BAND DESTROYED*, "*The Nottingham Evening Post*", Nottinghamshire, England, Thursday 06 April 1905, 3; BNA, *PRISONERS MASSACRED. Terrible Fate of a Servian Band, Uskub, April 6.*, "*The Western Times*", Devon, England, Thursday 13 April 1905, 4.

²⁹ BNA, *SERVIAN BAND DESTROYED*, "*The Nottingham Evening Post*", Nottinghamshire, England, Thursday 06 April 1905, 3; BNA, *SERVIAN BAND DESTROYED.*, (FROM OUR CORRESPONDENT.) VIENNA, April 6. "*The Standard*", London, England, Thursday 06 April 1905, 5.

³⁰ BNA, *BATTLE OF KUMANOVO TURKS SUFFER HEAVILY IN A FIGHT WITH A SERVIAN BAND*, "*The Morning Leader*", London, England, Friday 12 May 1905, 1; BNA, *SERVIAN FRONTIER FIGHT*, "*Evening Express*", Liverpool, Lancashire, England, Friday 12 May 1905, 7.

³¹ BNA, *MORNING EXPRESS*, "*The Manchester Courier*", Manchester, Lancashire, England, Thursday June 29 1905, 10.

ku kishte luftime ndërmjet bandave serbe edhe ushtrisë osmane. Gjatë dy luftimeve të zhvilluara në Vilajetin e Kosovës, trupat osmane pësuan me dyzet ushtarë të vrarë dhe të plagosur, kurse serbët tetëmbëdhjetë.³² Përveç luftimeve që zhvillonin me ushtrinë osmane dhe krimeve mbi popullsinë civile, në këtë periudhë bandat serbe luftonin edhe me bandat bullgare. Në ilustrim të kësaj mjafton të përmendim shpartallimin e një bande bullgare prej 25 vetash midis Krushevës dhe Prilepit në maj vitit 1906.³³ Po ashtu, një bandë serbe, në prill të vitit 1907, në Isvor, afër Shkupit, përveçse kishin mundur një bandë komitxhinjsh bullgarë, dhjetë prej tyre u ishin prerë kokat dhe në fund kishin djegur disa shtëpi të këtij fshati.³⁴ Pos atyre që u përmenden, *Reuters*, në janar të vitit 1907 raportonte se një bandë serbe kishte sulmuar një fshat bullgar afër Velesit dhe kishte vrarë dy persona. Por, megjithatë, trupat osmane kishin ndalur gjakderdhjen në këtë fshat, duke vrarë katër anëtarë të kësaj bande.³⁵ Rëndom, bandat serbe nuk i kursenin as gratë, sikurse në shkurt të vitit 1906 në fshatin Dupjan, afër Kërçovës, kur ishin vrarë pesë bullgarë, duke përfshirë tri gra.³⁶ Përveç vrasjeve, çetnikët kryenin dhe plaçkitje. Në shkurt të vitit 1907, *Reuters* raportonte se një bandë serbe prej pesëdhjetë vetash, kishin plaçkitur fshatin Stari Grad, afër Veleshit,

³² BNA, *TURK V. SERVIAN. PITCHED BATTLE*. [*Reuters Telegram*.] Belgrade, Monday., “*The Manchester Courier*”, Manchester, Lancashire, England, Tuesday 13 February 1906, 6.; BNA, *58 CASUALTIES IN SERVIAN FIGHT*., “*The Daily Mirror*”, London, England, Tuesday 13 February 1906, 4.

³³BNA, *Bulgarian Band Ambushed*, “*The Western Times*”, Exeter, Devon, England, Wednesday 24 May 1905, 4; BNA, *TURK V. SERVIAN. PITCHED BATTLE*. [*Reuters Telegram*.] Belgrade, Monday., “*The Manchester Courier*”, Manchester, Lancashire, England, Tuesday 13 February 1906, 6.; BNA, *58 CASUALTIES IN SERVIAN FIGHT*., “*The Daily Mirror*”, London, England, Tuesday 13 February 1906, 4; BNA, *FIGHTING IN MACEDONIA*., “*The Aberdeen Daily Journal*”, Aberdeenshire, Scotland, Monday 12 February 1906,6.

³⁴ BNA, *BULGARIAN BAND DEFEATED TEN KILLED AND BEHEADED (THROUGH REUTER'S AGENCY)* Salonika, Monday., “*The Daily Express*”, Dublin, Republic of Ireland, Tuesday 23 April 1907, 5.

³⁵ BNA, *NEWS IN BRIEF*, “*The Manchester Courier*”, Manchester, Lancashire, England, Thursday 18 January 1907, 1; BNA, *MORE BLOODSHED IN THE BALKANS*., “*The Scotsman*”, Edinburgh, Midlothian, Scotland, Thursday 17 January 1907, 7.

³⁶ BNA, *FIGHTING IN MACEDONIA*., “*The Aberdeen Daily Journal*”, Aberdeenshire, Scotland, Monday 12 February 1906, 6.

dhe kishin vrarë katër fisnikë bullgarë.³⁷ Nisur nga këto, gazeta *The Illustrated London News*, në fillim të qershorit të vitit 1907, nënvizonte se veprimi i pakontrolluar i bandave greke dhe serbe në Maqedoni shoqërohej me tmerre, të cilat as që mund të përshkruhen në shtyp.³⁸ Një shembull i këtillë ishte edhe ai i majit të vitit 1908, në fshatin Stratsin, në kazanë e Kratovës, ku një bandë serbe, pasi kishte djegur nëntëmbëdhjetë shtëpi dhe vrarë 5 fshatarë e plagosur një tjetër, ajo kishte djegur të gjallë dhe një grua. Ky krim i rëndë ishte shkaktuar nga banda e Vojislav Tankosić-it, i cili në këtë kohë ishte shef i shtabit malor.³⁹ Përveç djegieve të shtëpive, bandat serbe kryen edhe krime të tjera, si djegien e fermave dhe hambarëve etj., dhe gjithashtu përdornin bomba. Në fshatin Gradec të Kriva Pallankës, në

³⁷ BNA, *SERVIANS AND BULGARIANS FIGHT, (REUTER'S TELEGRAM.) SALONIKA, Thursday.*, "The Western Daily Press", Bristol, England, Saturday 16 February 1907, 12; BNA, "The Manchester Courier", Manchester, Lancashire, England, Saturday 16 February 1907, 7.

³⁸ BNA, *Balkan Unrest*, "The Illustrated London News", London, England, Saturday 01 June 1907, 7.

³⁹ Lidhur me këtë masakër, më 10 qershor shtypi britanik raportonte se në fshatin Stratsin, një bandë serbe sulmoi fshatin, duke djegur 43 shtëpi, stalla dhe hambarë, duke vrarë pesë fshatarë dhe plagosur rëndë një tjetër. Përveç tjerash, theksohej se një grua u dogj në shtëpinë e saj. Më tej potencohet "se babë e bir u morën me vete, ku djali u ther para syve të babait të tij, i cili më pas u vra". BNA, *MACEDONIAN MASSACRES*, "The Belfast News-Letter", Belfast, Antrim, Northern Ireland, Wednesday 10 June 1908, 7; BNA, *OUTRAGES BY GREEK BANDS*, "The Birmingham Daily Mail", Warwickshire, England, Wednesday 10 June 1908, 6; BNA, "The Manchester Courier", Manchester, Lancashire, England, Saturday May 30 1908, 7. Për këtë ngjarje studiuesi Sahara thekson se nga ky sulm numri i të vdekurve ishte katër dhe i të plagosurve ishte tetë. Sipas tij, dhjetë shtëpi u rrënuan dhe dhjetë të tjera u shkatërruan pjesërisht nga zjarri. Këto të dhëna përputhen afërsisht edhe me shifrat e raportuara nga Reuters. Sahara, "The Macedonian Origin of 'Black Hand'", in: Ed. Srdjan Rudić & Miljan Milkić, *ПРВИ СВЕТСКИ РАТ, СРБИЈА, БАЛКАН И ВЕЛИКЕ СИЛЕ - First World War, 417-418*; "A semi-official report states that a Serbian band, over a hundred strong, recently attacked the Bulgarian village of Statsin and burned nineteen buildings, with furniture and live stock. They killed five persons, and a woman was thrown living into the flames. —Reuter". BNA, *SERVIAN EXCESSES. Woman Thrown Alive Into the Flames. VILLAGE LOOTED.*, Sofia. Friday., "The Western Times", Exeter, Devon, England, Saturday 30 May 1908, 4. ; BNA, *SERVIAN OUTRAGE. A WOMAN BURNT ALIVE. (REUTER'S TELEGRAM.) SOFIA, Friday.*, "The Western Daily Press", Bristol, England, Saturday 30 May 1908, 10.

qershor të vitit 1908, banda e Tankosić-it, dogji nëntë ferma dhe disa hambarë. Këto veprime të bandave serbe kishin shqetësuar dhe konsullin austro-hungarez dhe atë rus, të cilët gjithashtu dënuan qeverinë serbe. Po ashtu, këto zhvillime e kishin detyruar Nikola Pašić-in të kërkonte nga konsullata në Shkup kthimin e Tankosić-it në Beograd.⁴⁰ Një shembull tjetër i krimeve të bandave serbe ishte ai në fshatin Mazhuçishtë, në rrethin e Prilepit, në qershor të vitit 1908, i cili është i veçantë nga krimet e bandave tjera për nga ashpërsia. Përveç vrasjes së një burri bullgar, banda serbe sulmoi dhe kortezhin e funeralit të viktimës, duke vrarë një kryemësues e gruan e tij dhe duke plagosur rëndë një fshatar tjetër. Një tjetër bandë serbe vrau pesë burra të fshatit Sekirtsu në të njëjtin rreth, duke i copëtuar viktimat jashtë fshatit.⁴¹ Pos të tjera, studiuesi Alexey Timofeev, vlerëson se për shkak të veprimtarisë së komiteteve bullgare, serbe dhe greke, bota për herë të parë u përball me dukuri të tilla si “terrorizmi” dhe “forcat policore ndërkombëtare”.⁴²

Nga ana tjetër, gjatë revolucionit xhonturk, Komiteti Bashkim e Përparim, pothuajse vetëm me bandat serbe nuk kishte zhvilluar bisedime ose bashkëpunuar si një përkrahëse e mundshme e tyre. Kjo ndodhte, pasi përkrahja e shqiptarëve të Kosovës për Komitetin Bashkim e Përparim, ishte jetike, dhe kështu, për të mos i ofenduar shqiptarët, i kishte injoruar bandat serbe. Udhëheqësit ushtarakë të

⁴⁰ BNA, *TROUBLE IN MACEDONIA, A VILLAGE DEVASTATED*, “The Western Daily Press”, Bristol, England, Wednesday 10 June 1908, 3; Sahara, “The Macedonian Origin of “Black Hand”, in: Ed. Srdjan Rudić & Miljan Milkić, *ПРВИ СВЕТСКИ РАТ, СРБИЈА, БАЛКАН И ВЕЛИКЕ СИЛЕ - First World War*, 417-418.

⁴¹ BNA, *BALKAN TROUBLES. Servian Bands Attack and Murder Village's*, Sofia, Sunday., “The Western Times”, Exeter, Devon, England, Monday June 15 1908, 4; “A Servian band recently attacked Bulgarian village the district of Perlape and killed one man, and the following day, during the funeral of the victim, the band attacked the procession, killed a schoolmaster and his wife, and seriously wounded another villager. Another Servian band carried off five of the principal men of the Bulgarian village Sekirtsu, the same district, and hacked them in pieces outside the village.” BNA, *WHERE REFORM IS NEEDED. [Reuters Telegram.]* Sofia, Sunday., “The Manchester Courier”, Manchester, Lancashire, England, Monday, June 15 1908, 10; BNA, *Bulgarian Village Attacked*, Sofia, Sunday., “The Irish News and Belfast Morning News”, Belfast, Antrim, Northern Ireland, Monday 15 June 1908, 5.

⁴² Timofeev, “Serbian Chetniks- Traditions of Irregular Warfare”, Ed. Katrin Boeckh and Sabine Rutar, in: *The Wars of Yesterday*, 262.

Turqve të Rinj ishin të vetëdijshëm se çetnikët nuk përbënin ndonjë rrezik për lëvizjen e tyre. Në këtë mënyrë qeveria serbe dhe bandat serbe qëndruan anash ndaj këtij zhvillimi dhe nuk kishin as një rol gjatë revolucionit.⁴³ Menjëherë pas revolucionit, shtatë drejtues të bandave serbe, të cilët vepronin në Maqedoni, e kishin informuar ministrin osman në Beograd, se me rivendosjen e Kushtetutës ata kishin vendosur që t'i dorëzonin armët dhe të ktheheshin në shtëpitë e tyre në Perandorinë Osmane. Me këtë ishte pajtuar dhe ministri osman në Beograd, pra që nënkuptohet, se të gjitha krimet e tyre me këtë rast ishin amnistuar.⁴⁴

⁴³ M. Şükrü Hanioglu, *Preparation for a Revolution The Young Turks, 1902-1908*, (New York: Oxford University Press, 2001), 253- 254.

⁴⁴ BNA, *SERVIAN BANDS LAY DOWN ARMS*, "The Standard", London, England, Thursday, 6 August 1908, 7; BNA, *SERVIAN BANDS IN MACEDONIA. CHIEFS LAY DOWN THEIR ARMS.*, "The Freeman's Journal and National Press", Dublin, Republic of Ireland, Thursday 06 August 1908, 7.

SERBIAN BANDS IN THE VILAYET OF KOSOVO AND THE VILAYET OF MANASTIR DURING THE YEARS 1903-1908

Summary

This paper will examine the structure, funding, and operational forms of Serbian bands in the Vilayet of Kosovo and the Vilayet of Manastir during the early 20th century. Additionally, it will explore the numerous crimes perpetrated by the Chetniks against the civilian population, along with their confrontations with Bulgarian bands, Ottoman troops, and Albanians. We are mainly based on the results of European and Balkan historiography; specifically, we have relied on the telegrams from “Reuters” news agency, as reported by the British press and located within “The British Newspaper Archive”. We have also utilized British documents from that period, which provide significant information into the funding of the Serbian bands.

Keywords: Bands, Chetnik, Vilayet of Kosovo, Vilayet of Manastir, Ottoman Empire, Serbia, etc.